



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 16/2023 (JR)
Datë 24.04.2023

Vendim nr. 23 (JR)
Datë 13.06.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 13.06.2023, ditën e martë, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Willem Brouwer, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 16/2023, datë 24.04.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 629, datë 03.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cengu.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 629, datë 03.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërprerjen e procesit dhe vendosjen e sanksionit të nenit G të Aneksit të

Kushtetutës subjektit të rivlerësimit Besnik Cengu, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Besnik Cengu, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pas shortit të hedhur në qershor të vitit 2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Më datë 12.12.2022, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me kërkesën për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, duke iu referuar nenit 27, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016), meqenëse ka mbushur moshën 60 vjeç dhe ka ushtruar funksionin e prokurorit për të paktën 30 vjet. Përveç këtyre kriterëve ligjore, subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e tij, bën me dije gjendjen e tij shëndetësore se prej më shumë se 10 vitesh, trajtohet nga kardiologu për diagnozat e sëmundjes infarkt miokardi, hipertension arterial, fibrilacion arterial dhe insuficiencë kardiake.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2023¹, vendosi: *1. Miratimin e pensionit të parakohshëm për zotin Besnik Cengu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. 2. Mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu më datë 14.02.2023. 3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Besnik Cengu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit [...].*
5. Pas administrimit të vendimit nr. {***}, datë 30.01.2023, “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror Besnik Cengu”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë², Komisioni, në lidhje me procesin e rivlerësimit, sipas orientimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimin (JR) nr. 1/2018, datë 11.06.2018, më datë 09.02.2023 i kërkoi subjektit të rivlerësimit të konfirmojë vullnetin e tij të pavesuar për dorëheqjen e dhënë pranë KLP-së, i cili passjell ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe

¹ Bazuar në nenin 27, pika 1, 1/2 dhe 3, nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 164, pika 8, nenin 166, pika 2, nenin 189, pika 1, germa “a” dhe nenin 190, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

² Përcjellë nga KLP-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2023, me lëndë: “Dërgohet vendimi nr. {***} i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

ndalimin sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni e njofton gjithashtu se vullneti në lidhje me dorëheqjen konfirmohet në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.

6. Me përgjigjen e datës 09.02.2023, subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë, konfirmon vendimin nr. {***}, datë 30.01.2023, të KLP-së, që ka pranuar kërkesën e tij për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit. Nëpërmjet këtij komunikimi, subjekti i rivlerësimi njofton se nuk dëshiron të paraqitet dhe të dëgjohet në seancë dëgjimore, si dhe nuk do të ankimojë vendimin e KLP-së, duke shprehur dakordësi të plotë me të.
7. Me administrimin e përgjigjes³ së Gjykatës Administrative të Apelit, se z. Besnik Cengu nuk kishte paraqitur kërkesëpadi ndaj vendimit nr. {***}, datë 30.01.2023, të KLP-së, Komisioni më 28.02.2023, njofton subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit që lidhen me dispozitat kushtetuese dhe ligjore që parashikojnë dorëheqjen nga detyra, dhe pasojën që vjen prej saj, si dhe e fton në seancë dëgjimore më datë 02.03.2023, për të cilën subjekti i rivlerësimit konfirmon paraqitjen.
8. Në seancën dëgjimore të datës 02.03.2023, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 4, pika 6, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, kërkoi të deklarohet i përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

9. Komisioni, me vendimin nr. 629, datë 03.03.2023, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, vendosi: *1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Besnik Cengu, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur [...].*

III. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

10. Një komision i përbërë nga tre vëzhgues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”) ka paraqitur më datë 06.04.2023, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, “Rekomandim për paraqitje ankimi”⁴ ndaj vendimit nr. 629, datë 03.03.2023, të Komisionit, duke arsyetuar se:

10.1. Komisioni ka zbatuar gabim nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe ka dështuar në interpretimin dhe zbatimin ashtu siç duhet të bazës kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme për këtë proces, përfshirë pasojat e mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2023, Gjykata Administrative e Apelit i përgjigjet kërkesës së Komisionit nr. {***} prot., datë 24.02.2023.

⁴ Shih rekomandimin e ONM-së nr. {***} prot., datë 06.04.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/04/Rekomandim-per-vendimin-e-KPK-se-nr.629-date-3.3.2023-per-s.r-Besnik-Cengu.pdf>.

e rivlerësimit, brenda kuadrit të procesit të rivlerësimit. Komisioni ka arsyetuar mbi disa dispozita ligjore dhe rrjedhimet sipas ligjit të statutit të magjistratit dhe Kodit të Procedurës Administrative, ndërkohë ka dështuar të shohë thelbin e funksioneve të tij kushtetuese, siç parashikohet në disa dispozita kushtetuese dhe, veçanërisht, në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, që ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit e lidh me pasojën e ndalimit të emërimit nga funksionet në sistemin e drejtësisë, për një afat 15-vjeçar.

10.2. Pensioni i parakohshëm dhe përfundimi i parakohshëm i statusit të magjistratit çon në pasoja për procesin e rivlerësimit të subjektit, për sa kohë që ai, me vullnet të lirë dhe në mënyrë të parakohshme, heq dorë nga ushtrimi i funksioneve. Heqja dorë me vullnet të lirë dhe në mënyrë të parakohshme nga ushtrimi i detyrës, çon në ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit dhe zbatimin e paragrafit 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

10.3. *Ratio* e nenit G të Aneksit të Kushtetutës pasqyron rregullin themelor të reformës në drejtësi, i cili kërkon që të gjitha subjektet e rivlerësimit t'i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar para se të vazhdojnë të shërbejnë në sistemin (e ri) e drejtësisë. Dështimi për të kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, passjell për subjektet e parivlerësuar ndalimin e emërimit për një afat 15-vjeçar në sistemin e drejtësisë. Në këtë perspektivë, mbarimi i statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, arritjes së moshës për pension apo pensionit të parakohshëm, çon në ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit për subjekte rivlerësi që nuk e gëzojnë më këtë cilësi dhe, si pasojë, sjell ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit.

10.4. Nga ana tjetër, është e mundshme që ish-subjekte rivlerësi që nuk janë rivlerësuar, pasi procedura e tyre e rivlerësimit është ndërprerë, të bëhen sërish pjesë e sistemit të drejtësisë si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, anëtarë të KLP-së apo KLGj-së, derisa të mbushin moshën 70 vjeç, e cila është mosha maksimale për të shërbyer në sistemin e drejtësisë. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka arritur këtë moshë.

IV. Ankimi i Komisionerit Publik

11. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisioneri Publik”), në mbështetje të rekomandimit për paraqitje ankimi, ka ushtruar ankim⁵ kundër vendimit nr. 629, datë 03.03.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji, ndryshimin e këtij vendimi dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Komisioneri Publik ngre këto shkaqe ankimi:

11.1. Arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Komisioni në vendim, nuk është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit⁶.

11.2. Në referencë të jurisprudencës⁷ së Kolegjit, mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të

⁵ *Shih ankimin e Komisionerit Publik me nr. {***} prot., datë 11.04.2023, në faqen zyrtare në internet të Institucionit të Komisionerëve Publikë: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/04/Ankim-kund%3%ab-vendimit-nr.-629-dat%3%ab-3.3.2023-t%3%ab-KPK-s%3%ab-p%3%abr-subjektin-e-rivler%3%absimit-z.-Besnik-Cengu.pdf>.*

⁶ *Vendimet (JR) nr. 37/2020, nr. 9/2021 dhe nr. 13/2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

⁷ *Vendimi (JR) nr. 13/2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

daljes në pension pleqërie, parashikuar nga neni 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por, në të njëjtën kohë e në mënyrë të pashmangshme, afekton dhe procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

11.3. Subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit prokuror dhe, për pasojë, të gjitha përfitimet që rrjedhin prej tij, duke fituar dhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension pleqërie, 67 vjeç. Ushtrimi i kësaj të drejte shoqërohet në të njëjtën kohë me mbajtjen e statusit të magjistratit dhe me detyrimin për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit. Nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet nga subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe për shkak të daljes në pension të parakohshëm, bazuar në zgjedhjen e tij sipas parashikimit të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, sjell si pasojë ligjore ndalimin sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Besnik Cengu, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 629, datë 03.03.2023, për subjektin e rivlerësimit Besnik Cengu, u

mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet të ankimit

15. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ishte shortuar në qershor 2020 dhe ndaj tij kishte filluar hetimi administrativ në Komision dhe konkretisht i ishte përcjellë për përgjigje pyetësori standard dhe pyetësori i dytë. Përgjatë periudhës së hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar KLP-së, me kërkesë për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, me argumentin se plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 27, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, pasi: *a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç; b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit.* Përveç plotësimit të kriterëve ligjore për pension të parakohshëm, nëpërmjet kësaj kërkesë subjekti i rivlerësimit bën të ditur edhe situatën e tij shëndetësore, mbi trajtimin nga kardiologu për diagnozat e sëmundjes së miokardit, hipertension arterial, fibrilacion arterial dhe insuficiencë kardiake, për një periudhë mbi 10 vjet.
16. Pasi administroi vendimin nr. {***}, datë 30.01.2023, të KLP-së “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror Besnik Cengu”, dhe konfirmimin nga Gjykata Administrative e Apelit, se subjekti i rivlerësimit nuk kishte ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, Komisioni si nëpërmjet pyetjes së datës 09.02.2023 dhe barrës së provës kaluar me rezultatet e hetimit, i ka parashtruar subjektit të rivlerësimit konstatimet e tij në këndvështrim të dispozitave kushtetuese e ligjore që lidhen me dorëheqjen nga detyra dhe parashikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
17. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, duket që Komisioni ka pranuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet mbi rezultatet e hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, duke arsyetuar në vendim se:
 - 17.1. Në asnjë paragraf të kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, as në vendimin e KLP-së nuk konstatohet si shkak për mbarimin e statusit të magjistratit *“dorëheqja nga detyra”*. Në vlerësim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur kriteret e përcaktuara nga neni 27, pika 1, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, për të përfituar pension të parakohshëm, dhe ka qenë plotësisht i legjitimuar në kërkimin e tij dhe të drejtën e pakufizuar të njohur nga ligji për daljen në pension të parakohshëm, bazuar në nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016 dhe nenin 52 të Kushtetutës. Në këto kushte, Komisioni ka çmuar se vendimmarrja e tij bazohet në parimin e ligjshmërisë, të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, pavarësisht arsyeve shëndetësore që e kanë vënë në lëvizje për të kërkuar daljen në pension të parakohshëm.
 - 17.2. Për të mbështetur konkluzionin e tij, Komisioni në vendim trajton në pozita të barabarta “pensionin e parakohshëm” dhe “pensionin e plotë të pleqërisë”, duke u shprehur se kërkesa për miratimin e pensionit të parakohshëm nuk mund të kualifikohet apo barazohet si dorëheqje nga detyra, që në vlerësim të Komisionit, duket si mjet për t’iu shmangur procesit të

rivlerësimit, e me të drejtë ligjvënësi e ka shoqëruar me penalizimin e parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, ndërkohë që nuk është parashikuar kështu për kërkesën për daljen në pension të parakohshëm. Aplikimi i këtij neni në çështjen objekt shqyrtimi do të shkelte parimin e sigurisë juridike dhe do të cenonte parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative. Vendimmarrja në ndryshim të këtij arsytimi do ta penalizonte pa ligj subjektin e rivlerësimit dhe do të binte ndesh me Kushtetutën, ligjin dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas Komisionit, shkakua objektiv i largimit nga detyra, në rastin konkret, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 96/2016, nuk ndërlidhet me shkakun subjektiv sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

18. Duke e gjetur të gabuar arsyetimin e Komisionit, Komisioneri Publik ka ankimuar përfundimin e arritur nga Komisioni në vendim, duke e konsideruar atë rrjedhojë të zbatimit jo të drejtë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit⁸. Mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të daljes në pension pleqërie, parashikuar nga neni 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, në referencë të jurisprudencës⁹ së Kolegjit, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por, në të njëjtën kohë e në mënyrë të pashmangshme, afekton dhe procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Sipas Komisionerit Publik, ushtrimi i së drejtës për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension pleqërie, 67 vjeç, shoqërohet në të njëjtën kohë me mbajtjen e statusit të magjistratit dhe me detyrimin për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit. Mosushtrimi i kësaj të drejte nga subjekti i rivlerësimit, qoftë edhe për shkak të daljes në pension të parakohshëm, bazuar në zgjedhjen e tij sipas parashikimit të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, sjell si pasojë ligjore ndalimin sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

19. Në parashtrimet e tij gjatë seancës gjyqësore publike të datës 12.06.2023 në Kolegj, duke gjetur të drejtë bazën ligjore të zbatueshme dhe konkluzionin e Komisionit në vendim, subjekti i rivlerësimit kundërshton ankimin e Komisionerit Publik, si tërësisht të paligjshëm e të pabazuar në prova e në ligj. Në këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit propëson në mënyrë të përmbledhur se:

19.1. Vetëm dorëheqja nga detyra, parashikuar në nenin 64, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, passjell ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e sanksionit në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe jo mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të miratimit të pensionit të parakohshëm. Kërkesa për miratimin e pensionit të parakohshëm, nuk mund të konsiderohet si shprehje e vullnetit për të ndërprerë marrëdhëniet e punës ose për të lënë para kohe detyrën, përkundrajt mundësisë ligjore për të vazhduar funksionin, por një e drejtë kushtetuese e ligjore qoftë për të dalë në pension të parakohshëm, qoftë pension të plotë kur mbush moshën 67 vjeç. Shkaqet që çuan në paraqitjen e kërkesës pranë KLP-së, janë objektive, të pavarura nga vullneti i subjektit të rivlerësimit, që lidhen me gjendjen e tij të rënduar shëndetësore, vërtetuar me shkresa të pakundërshtueshme që provojnë se nga data 25.08.2012,

⁸ Vendimet (JR) nr. 37/2020, nr. 9/2021 dhe nr.13/2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁹ Vendimi (JR) nr. 13, datë 16.05.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Bica.

subjekti i rivlerësimit vuan nga infarkti i miokardit, hipertensioni arterial, fibrilacioni atrial dhe insuficenca kardiake kronike në stad 3-4, dhe që kanë pamundësuar ushtrimin më tej të detyrës deri në moshën e parashikuar nga ligji.

19.2. Rasti i shqyrtuar nga Kolegji, i sjellë në vëmendje në ankimin e Komisionerit Publik¹⁰, nuk ka asnjë lloj ngjashmërie me rastin në gjykim, e që për shkak të specifikave të veçanta dhe arsytimi do të jetë ndryshe nga rastet e tjera. Komisioneri Publik, sipas subjektit të rivlerësimit, e mbështetet ankimin në arsytime teorike dhe hamendësime se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, duke anashkaluar me qëllim dhe pa përmendur vendimin e KLP-së, si organi i vetëm kushtetues e ligjor që vendos sipas ligjit, rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, si akti kryesor mbi të cilin ka vendosur Komisioni. Situata faktike e subjektit të rivlerësimit nuk duhet të kualifikohet sipas parashikimeve të germës "a" të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, si dorëheqje nga detyra. Në ndryshim nga kërkesa për pension të parakohshëm, kërkesa për dorëheqje nga detyra mund të jetë dhe e pamotivuar (neni 65, pika 1 e ligjit nr. 96/2016). Instituti i dorëheqjes nga detyra dhe instituti i pensionit të parakohshëm, si të drejta të magjistratit, rregullohen me bazë ligjore të ndryshme, sjellin pasoja personale e financiare të ndryshme, por ndërkohë që dalja në pension të parakohshëm lidhet domosdoshmërisht me plotësimin e 2 (dy) kushteve ligjore, dorëheqja është shprehje e vullnetit subjektiv. Këto dy institute nuk mund të ndërlidhen dhe as nuk duhen konfliktuar në dëm të pozitës së subjektit të rivlerësimit.

19.3. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje vendimin nr. {***}, datë 25.10.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilin theksohet se rëndësi themelore në procesin e deklarimit të përfundimit të statusit të magjistratit, paraqet edhe identifikimi i saktë në vendim, i shkakut të përfundimit të tij, pasi për secilin nga rastet e nenit 64, pika 1, ligji ka parashikuar pasoja dhe efekte juridike, të cilat prekin interesat e ish-magjistratit. Heqja dorë nga statusi i magjistratit duhet miratuar nga Këshillat vetëm në ato raste kur kërkesa përmban në mënyrë të shprehur qartë dhe pa asnjë ekuivok, vullnetin e magjistratit për të mos vijuar më tej ushtrimin e profesionit. Dalja në pension është një e drejtë dhe jo një detyrim, dhe magjistrati në momentin që plotëson kushtet e daljes në pension, nuk ndalohej të përfitojë nga ajo që ligji i ka njohur. Perceptimi i gabuar mbi moshën e magjistratit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, nuk mund të barazohet me rastin e heqjes dorë nga statusi.

19.4. Dalja në pension pleqërie, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk sjell si pasojë detyrimin për t'iu nënshtroar procesit të rivlerësimit, pasi këtë të drejtë ia ka dhënë ligji i posaçëm i magjistratit, ligj i cili prevalon mbi ligjet e tjera.

- 20.** Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankim dhe në parashtrime, dëgjoi dhe analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore, vlerësoi të gabuar konkluzionin e Komisionit, për të mos aplikuar nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, konkluzion ky që vjen në kundërshtim me jurisprudencën e vetë Komisionit, por edhe të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 13, datë 16.05.2022, në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Bica, që

¹⁰ Shih, vendimin (JR) nr. 13, datë 16.05.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Bica.

ndodhej në të njëjtat kushte me subjektin e rivlerësimit Besnik Cengu, e për të cilin Komisioni kishte disponuar ndryshe. Për çështjen objekt shqyrtimi, trupi gjykues arsyeton si vijon:

20.1. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, i rëndësishëm është fakti i evidentimit të vullnetit të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar këtë proces. Në jurisprudencën e deritanishme, për subjektet e rivlerësimit ndaj të cilëve ka filluar hetimi administrativ dhe procesi është ndërprerë me vullnetin e tyre, në rastin e dorëheqjes nga detyra, pensionit të parakohshëm, apo pa mbushur moshën e pensionit të plotë të pleqërisë (67 vjeç) sipas parashikimit të ligjit nr. 96/2016, Kolegji ka zbatuar nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ndalimin për t'u emëruar *gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*. Në këto kushte, vendimi nr. {***}, datë 25.10.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë¹¹, sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, është pa efekt për procesin e rivlerësimit. Në çështjen objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit ka shprehur vullnetin për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, për daljen në pension të plotë pleqërie të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, nëpërmjet kërkesës “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit të prokurorit Besnik Cengu”.

20.2. Duke u pajtuar me arsyetimin e Komisionit dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se instituti i “*daljes në pension të parakohshëm*” është i ndryshëm nga ai i “*dorëheqjes nga detyra*”, ky ndryshim, në vlerësim të trupit gjykues, afekton subjektin e rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së prokurorit, si dhe pasojën financiare që vjen prej tyre, në kuptim të ligjit nr. 96/2016, ndërkohë që në drejtim të procesit të rivlerësimit, është detyra e institucioneve të rivlerësimit të verifikojnë nëse ndodhemi përpara mbarimit të statusit të magjistratit me vullnetin e subjektit, e për ta vlerësuar më pas në dritën e dispozitave kushtetuese të procesit të rivlerësimit. Për të arritur në konkluzionin se nuk ndodhemi përpara *dorëheqjes*, nuk është e mjaftueshme vetëm mosparaqitja në mënyrë formale e një kërkesë që titullohet dorëheqje apo mospërdorimi i kësaj fjale në kërkesat që subjekti i rivlerësimit i paraqet KLP-së, por verifikimi i qëllimit në vetvete që kërkon të arrijë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës për mbarimin e statusit të magjistratit.

20.3. Pensioni i parakohshëm, në vlerësim të trupit gjykues, është një mënyrë që ligji u njeh magjistratëve, të cilët plotësojnë disa kriteret ligjore, për të lënë më herët detyrën sesa moshë e zakonshme e daljes në pension të tyre. Kërkesa për “*pension të parakohshëm*” dhe dalja në “*pension të plotë pleqërie*” për shkak të mbushjes së moshës 67 vjeç, nuk mund të konsiderohen të barasvlershme, sa i përket pasojës që vjen prej tyre në kuadër të procesit të rivlerësimit. Pensioni i plotë i pleqërisë qëndron i pavarur nga vullneti i magjistratit për të vazhduar ose jo ushtrimin e funksionit. Me mbushjen e moshës së pensionit, magjistrati nuk i

¹¹ Shih: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Ceshtje_themeli_8576_1-8572.php; vendimi nr. {***}, datë 25.10.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i përket çështjes administrative me paditës B. M., i paditur Këshilli i Lartë të Prokurorisë, person i tretë Prokuroria e Përgjithshëm, me objekt: “Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. {***}, datë 15.10.2020, me të cilin është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit [...]”, që ka disponuar me “[...] pranimin e pjesshëm të padisë. Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje”.

drejtohet me kërkesë KLP-së, për t'i bërë të ditur që plotëson kushtet për pension pleqërie, pasi është vetë këshilli, që në rolin e punëdhënësit, deklaron kryesisht mbarimin e mandatit të magjistratit, sipas parashikimit të nenit 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016: [...] *Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.*

20.4. Nga analizimi i nenit 27, pikat 1 dhe 1/1 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues konstaton se ligji i njeh të drejtën magjistratit për pension të parakohshëm në dy raste: *i pari*, kur ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç dhe e ka ushtruar detyrën për të paktën 30 vjet; dhe *i dyti*, për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore të magjistratit sipas nenit 67 të këtij ligji. Në këtë drejtim, pavarësisht situatës shëndetësore të subjektit të rivlerësimit, sipas akteve shkresore¹² të depozituara prej tij dhe të pranuara në cilësinë e provës nga trupi gjykues në Kolegj, me vendim të ndërmjetëm, më datë 12.06.2023, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi situatën shëndetësore, nuk janë paraqitur në kërkesën drejtuar KLP-së, si një shkak më vete për mbarimin e statusit të magjistratit, në përputhje me nenet 64 dhe 67 të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, qëndrimi i Komisionit në vendim dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi gjendjen e tij shëndetësore, do të kishin peshë nëse vendimi i KLP-së, për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, do të ishte bazuar në nenin 27, pika 1/1 dhe nenin 67 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilëve magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore, për të cilin Këshilli heton, autorizon një komision me ekspertë për të dhënë mendim të specializuar, dhe vendos sipas rastit pezullimin përkohësisht ose mbarimin e statusit të magjistratit. Ndërkohë që dispozitat në kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe ato të aplikuara nga KLP-ja në vendim, konkretisht neni 27, pikat 1, 1/2, dhe 3, neni 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016¹³, bëjnë të pabazuar arsyetimin e Komisionit në vendim, si dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

¹² i. Raporti i daljes nga spitali i datës 28.08.2012, me numër kartele shtrimi {***}, Spitali {***} Tiranë; ii. Raport i Revaskularizimit Koronar, datë 25.08.2012, Spitali {***} Tiranë; iii. Raport i Koronarografisë, datë 25.08.2012, Spitali {***} Tiranë; iv. Fletë drejtimi për K.E.M.P, datë 28.08.2012, Spitali {***} Tiranë; v. Raport dalje nga spitali, datë 20.12.2019, Spitali {***} Tiranë; vi. Përgjigje echo-kardiografike, datë 28.09.2020, Fondacioni “{***}”, Tiranë; vii. Ekokardiografi transtorakale, datë 06.09.2022, Qendra Shëndetësore {***}; viii. Vizitë kardiologjike, EKG, Ekodopler, datë 18.02.2022, Qendra Spitalore Universitare “{***}”, Tiranë; ix. Raport për paaftësi të përkohshme në punë, nr. {***}, datë 13.09.2022, i Komisionit Mjeko-Ligjor të Kardiologjisë; x. Raport për paaftësi të përkohshme në punë nr. {***}, datë 18.10.2022, i Komisionit Mjeko-Ligjor të Kardiologjisë Tiranë; xi. Raport për paaftësi të përkohshme në punë nr. {***}, datë 18.11.2022, i Komisionit Mjeko-Ligjor të Kardiologjisë, Tiranë.

¹³ Neni 27, pikat 1, 1/2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 parashikojnë: “1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse: a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç; b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit [...] 1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfutimit deri në plotësimin e kushteve për përfutimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfutimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0,6 për qind në muaj. [...] 3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.

Neni 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e po këtij ligji, parashikon: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji [...] 5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën

20.5. Duke e konsideruar pensionin e parakohshëm si një të drejtë që e njeh ligji nr. 96/2016 në nenin 27, pika 1 e tij, përkundrejt shprehjes së vullnetit dhe zgjedhjes së subjektit të rivlerësimit për të mos vazhduar të qëndrojë në detyrë deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, jo si një të drejtë që buron drejtpërsëdrejti nga ligji dhe zbatohet si e tillë, në kushtet kur për shkak të ligjit, subjekti është i përfshirë edhe në një proces tjetër, siç është procesi i rivlerësimit, mbarimi i statusit të magjistratit nuk jep efekte vetëm në ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë e në mënyrë të pashmangshme afekton dhe procesin e rivlerësimit, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

20.6. Referuar qëndrimit në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik se, subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit prokuror dhe, për pasojë, të gjitha përfitimet që rrjedhin prej tij, duke fituar dhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension pleqërie 67 vjeç. Ushtrimi i kësaj të drejte shoqërohet në të njëjtën kohë me mbajtjen e statusit të magjistratit dhe me detyrimin për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit.

21. Në çështjen objekt shqyrtimi, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se ushtrimi i së drejtës për të përfituar pension të parakohshëm në këtë fazë, e gjatë procesit të rivlerësimit, shoqërohet me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Për sa kohë subjekti i rivlerësimit zgjedh daljen në pension të parakohshëm, sipas parashikimit të nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, ky veprim dëshmon mungesë vullneti për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, me pasojë ligjore ndalimin sipas parashikimit të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
22. Në përfundim të verifikimit të situatës faktike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm dhe akteve në fashikull, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 629, datë 03.03.2023, për deklarimin të përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar për z. Besnik Cengu, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, dhe pa zbatuar në këtë rast parashikimet e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është marrë në konstatim të gabuar të situatës faktike, në zbatim të gabuar të ligjit dhe, për rrjedhojë, duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës [...]”.

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 629, datë 03.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë:
 - i. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Besnik Cengu, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - ii. Në zbatim të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit Besnik Cengu, për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 13.06.2023.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi